Mbështesim zhvillimin e kompetencave transkulturore për profesionistët e shëndetit në Ballkanin perëndimor.

Supporting development of TransCultural Competence for healthcare professionals in the Western Balkans, TCCWB



Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastër
Albania

Co-funded by the Erasmus+ Programme of the European Union

Studim rasti klinik-2
Kujdesi për shtatzaninë në konsultorin e gruas, rasti i një vajze nga komuniteti Rom

- **Pacientja:** Xhesika, 19 vjeçe, pjesëtare e komunitetit rom.
  Diagnoza e pranimit: Shtatzëni në javën e 35-të, dhimbje të lehta në fund të barkut, ankth.
  Gendja familjare: E martuar sipas traditës së komunitetit (jo zyrtarisht), jeton në një lagje periferike në kushte të vështira socio-ekonomike.
- **Historia Mjekësore:**
- Xhesika paraqitet në maternitet e shoqëruar nga vjehrra e saj dhe dy gra të tjera të afërme të komunitetit.
  Gjatë ekzaminimit fillestar, infermierja e triazhit vëren se:
- Xhesika nuk ka bërë **asnjë vizitë antenatale** gjatë gjithë shtatzënisë.
- Ajo nuk ka një kartelë shëndetësore të hapur te mjeku i familjes dhe nuk ka bërë asnjë eko.
- Nuk ka marrë suplemente të acidit folik apo hekurit.
- Pacientja flet pak shqip ndërsa gratë e tjera flasin më mire. Xhesika shfaq tension mendor, shikon vazhdimisht nga vjehrra përpara se të përgjigjet dhe refuzon të kryejë ekzaminime pa praninë e grave të familjes.

Studim rasti klinik-2
Kujdesi për shtatzaninë në konsultorin e gruas, rasti i një vajze nga komunitetit Rom



- Komunikimi: Jemi pa përkthyes; mund të ketë keqkuptime.
- Besime dhe praktika: Pacientja nuk vendos vet.
- Konteksti social:
  Kultura e komunitetit.
  Jetesa e kufizuar brenda komunitetit të tyre dhe mungesa e integrimit me popullsinë shqiptare.
  Nuk e njohin dhe as e kuptojnë protokollin e ndjekjes së shtatzanisë në sistemin tone shëndetësor.
- Mungesa e besimit**:** Historiku i diskriminimit sistematik bën që komuniteti Rom të ketë mosbesim ndaj institucioneve shtetërore.

Studim rasti klinik-2
Kujdesi për shtatzaninë në konsultorin e gruas, rasti i një vajze nga komuniteti Rom

- Ndërhyrjet infermierore
- Menaxhim i komunikimit: trego durim, përdor pyetje të thjeshta, dëgjo me kujdes
- Respektim i vlerave: respekto preferencat e pacientit
- Edukim i përshtatur: shpjegimi i gjëndjes dhe egzaminimeve që duhet të kryhen në një mënyrë të përshtatshme për pacienten dhe personat që e shoqërojnë.
- Dokumentim: Regjistro preferencat dhe nevojat e pacientit në kartelë